



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 2182 Prot

Shkodër me 31.03 2026

### V E N D I M

Nr. 62, Datë 27.03.2026

### “PËR SHITESË PLANI NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2026, NË KUADËR TË FONDIT SOCIAL”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2026, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Për shtesë plani në Buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026, në kuadër të fondit social”, bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 87/2025 “Per Buxhetin e Vitit 2026”, pikat 1, 2/b të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, shkresa nr.5055/9, datë 29.12.2025 “Njoftim” dhe shkresa 592/1 datë 30.01.2026 “Transferim fondesh për financimin e shërbimeve të përkujdesit në nivel qarku dhe bashkie” të MSHMS, Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **14 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,**

### V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026, Transferte e Kushtëzuar nga MSHMS, për financimin e shërbimeve të specializuara të përkujdesit shoqëror rezidencial për persona me aftësi të kufizuara në shumën totale **26,054,201 lekë** dhe përkatësisht:
  - a. Financim për Shtëpi-Familje Madonnina della Grappa” për vitin 2026 në programin 10430 , Art 6060000, shpenzime korentë, shumën **6,023,656 lekë.**
  - b. Financim për Qendrën Ditore “Buzëqeshja e Motër Lezes” ofruar nga Shtëpi-Familje Madonnina della Grappa” për vitin 2026 në programin 10430 , Art

6060000, shpenzime korente, shumën **8,156,413 lekë**.

c. Financim për Shtëpi-Familje “Shtëpia Rregullatore e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative” për vitin 2026 në programin 10430, Art 6060000, shpenzime korente, shumën **11,874,132 lekë**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

**KRYETARI**

**Edmond NDOU**

